



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr1556/5 prot.

Datë 08.08.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 761/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.08.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-35897-07-08-2022, me objekt *Loti II “Blerje Letër A5 “Traktor” (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)*”, me fond limit 33.972.532 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 15.08.2022, nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-35897-07-08-2022, me objekt *Loti II “Blerje Letër A5 “Traktor” (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)*”, me fond limit 33.972.532 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 15.08.2022, nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

“Inpress” SHPK

Rruga “Siri Kodra”, ish blloku i magazinave tregtare, Tiranë

“Infosoft Office” SHPK

*Kodër Kashar, Autostrada Tiranë Durrës Km8, Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:**

Posta Shqiptare SHA

Rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomik janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.07.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-35897-07-08-2022, me objekt *Loti II “Blerje Letër A5 “Traktor” (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)*”, me fond limit 33.972.532 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 15.08.2022, nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA.

II.2. Në datën 19.07.2022 operatori ekonomik “Inpress” SHPK, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, ankesën nr. 1556/2022 protokoll, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.2.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.2.2. Nëpërmjet shkresës nr.1637/12 prot., datë 02.08.2022, protokolluar me tonën me nr.1556/4 prot., datë 04.08.2022, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë institucionit tonë aktin e trajtimit e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2.3. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes “Inpress” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin e ankesës si më poshtë:

*Pika 2.3.2 Ishte:*

*2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Prill 2022 – Qershor 2022, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë mesatarisht 20 punonjës të siguruar në muaj.*

***Pika 2.3.2 Bëhet:***

***2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Prill 2022 – Qershor 2022, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë mesatarisht 15 punonjës të siguruar në muaj.***

*Pika 2.3.5 Ishte:*

*2.3.5 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 2 makina tip furgon në pronësi ose me kontratë qeraje me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës, për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet duhet të jenë të pajisura me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikate pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/SGS”.*

***Pika 2.3.5 Bëhet:***

***2.3.5 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 1 makinë tip furgon në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës; për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet duhet të jenë të pajisura me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/SGS”.***

*Pika 2.3.4 Ishte:*

*2.3.4 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të provohet lidhja mes prodhuesit dhe distributorit të autorizuar, në rast se OE nuk është prodhues i këtyre artikujve, si dhe duhet të dorëzojë skedat tenike për letrat e përdorura gjatë prodhimit të letres traktor. Specifikimet teknike të jenë të certifikuar dhe testuar nga prodhuesi (me firmë dhe vulë) ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje)”, Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet Letër A5, “Traktor” (3 kopje)”, Letër A4 “Traktor” në përputhje me specifikimet teknike përkatëse”.*

**Pika 2.3.4 Bëhet:**

**2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar për letrat e përdorura për prodhimin e letres traktor, si dhe duhet të dorëzojë skedat tenike për letrat e përdorura gjatë prodhimit të letres traktor, të çertifikuar dhe testuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” ” (3 kopje)”.**

**Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.**

II.3. Në datën 21.07.2022 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, ankesën nr. 1589/2022 protokollin, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.3.2. Nëpërmjet shkresës nr.1637/15 prot., datë 04.08.2022, protokolluar me tonën me nr.1589/2 prot., datë 08.08.2022, si dhe shkresës nr. 1637/22 prot datë 08.08.2022 protokolluar me tonën nr. 1589/3 prot datë 09.08.2022 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë institucionit tonë aktin e trajtimit e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3.3. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pjesërisht pranimin e ankesës si më poshtë:

[...]Lidhur me pretendimin e nritur për kriterin e vendosur parashikohet:

**2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

- *Certifikate ISO 9001:2015; ( për sistemin e menaxhimit të cilësisë); (ose ekuivalente)*
- *Certifikate ISO 14001:2015, (për sistemin e menaxhimit mjedisor); (ose ekuivalente)*
- *Certifikate ISO 45001:2018 (për sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë për kompaninë) (ose ekuivalente)*

*(Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).*

*Ku kërkohet sqarim nëse ISO-t kërkohet të jenë të treja të operatorit ofertues?*

*Ju sqarojmë se:*

*Në dst për përmbushjen e këtij kriteri kërkohet që të tre ISO-të të jenë të operatorit ofertues (kompanisë ofertuese) pasi edhe nga rekomandimet e APP-së këshillohet të mos kërkohet Certifikatë ISO për kompani të treta. Edhe nëse shqyrtoni procesverbalin e argumentimit të kriterëve publikuar së bashku me dokumentet e tenderit në SPE ndër të tjera për argumentimin e pikës 2.3.2 është argumentuar se:*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.*

*Megjithatë me qëllim shmangien e çdo konfuzioni për operatorët ekonomikë të interesuar lidhur me këtë procedurë prokurimi do të behën sqarimet dhe modifikimet përkatëse.*

*Pika 2.3.3.*

*Ishte*

*2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- Certifikate ISO 9001:2015; ( për sistemin e menaxhimit të cilësisë); (ose ekuivalente)*
- Certifikate ISO 14001:2015, (për sistemin e menaxhimit mjedisor); (ose ekuivalente)*
- Certifikate ISO 45001:2018 (për sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë për kompaninë) (ose ekuivalente)*

*(Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).*

*Pika 2.3.3.*

*Bëhet:*

*2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

*Certifikate ISO 9001:2015; ( për sistemin e menaxhimit të cilësisë për ofertuesin); (ose ekuivalente)*

*Certifikate ISO 14001:2015, (për sistemin e menaxhimit mjedisor për oferuesin); (ose ekuivalente)*

*Certifikate ISO 45001:2018 (për sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë për kompaninë për ofertuesin) (ose ekuivalente)*

*(Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).*

*Për sa më sipër pretendimi juaj vlerësohet i drejtë.*

*Lidhur me pretendimin e ngritur për specifikimet teknike ku është kërkuar:*

- I. Letër A5 “Traktor” në 3 kopje*
- II. Letër A4 “Traktor” në 3 kopje*

*Ju sqarojmë se:*

*Në shtojcën 5 specifikimet teknike për produktin Letër A5 Traktor (3kopje) letër A4 “Traktor” (3 kopje)do të bëhen modifikimet teknike si vijon:*

*Ishte:*

### **I. Letër A5 "Traktor" në 3 kopje**

- -format A5, letër vetekopjuese.
- -letër traktor me 3(tre) kopje, të treja të bardha.
- -me biosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforcuar.
- -paketimi në kuti me 1400 fije treshe.

### **II. Leter A4 "Traktor" ne 3 kopje**

- -format A4, letër vetekopjuese.
- -letër traktor me 3(tre) kopje, të treja të bardha.
- -me biosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforcuar.
- -paketimi në kuti me 1400 fije treshe.

## **Bëhen**

### **1. Letër A5 "Traktor" në 3 kopje**

- -format A5, **me përmasat e jashtme 234±5mm x 304/152±5mm**, letër vetekopjuese,
- -letër traktor me 3(tre) kopje, të treja të bardha.
- -me biosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforcuar.
- -paketimi në kuti me 1400 fije treshe.

#### **Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back**

Pesha : 58 + - 4% g/m<sup>2</sup>

Trashësia: 80+ - 6 µm

Ashpersia ne perkulje: MD > 11 mN

Ashpersia ne perkulje: CD > 3 mN

Lemueshmeria > 15 Bekk S

Lageshtira relative 50+ - 8 %

Patejdukshmeria > 79 %

Ndricimi 102 + - 3 %

#### **Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back**

Pesha: 58 + - 4% g/m<sup>2</sup>

Trashësia 78+ - 5 µm

Ashpersia ne perkulje: MD > 11 mN

Ashpersia ne perkulje: CD > 3 mN

Lemueshmeria > 30 Bekk S

Lageshtira relative 50+ - 8 %

Ndriçimi 94+ - 3 %

#### **Faqja trete- kopja para CF coated front**

<i>Pesha:</i>	60 + - 4% g/m <sup>2</sup>
<i>Trashesia:</i>	73+ - 6 μm
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	MD > 12 mN
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	CD > 4 mN
<i>Lemueshmeria</i>	> 30 Bekk S
<i>Lageshtira relative</i>	50+ - 8 %
<i>Ndricimi</i>	94+ - 3 %

## **2. Leter A4 "Traktor" ne 3 kopje**

- -format A4 me përmasat e jashtme: 234±5mm x 304± 5mm, letër vetekopjuese,
- -letër traktor me 3(tre) kopje, të treja të bardha.
- -me birosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforuar.
- -paketimi në kuti me 1400 fije treshe.

### ***Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back***

<i>Pesha:</i>	58 + - 4% g/m <sup>2</sup>
<i>Trashesia:</i>	80+ - 6 μm
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	MD > 11 mN
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	CD > 3 mN
<i>Lemueshmeria</i>	> 15 Bekk S
<i>Lageshtira relative</i>	50+ - 8 %
<i>Patejdukshmeria</i>	> 79 %
<i>Ndriçimi</i>	102 + - 3 %

### ***Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back***

<i>Pesha:</i>	58 + - 4% g/m <sup>2</sup>
<i>Trashesia:</i>	78+ - 5 μm
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	MD > 11 mN
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	CD > 3 mN
<i>Lemueshmeria</i>	> 30 Bekk S
<i>Lageshtira relative</i>	50+ - 8 %
<i>Ndriçimi</i>	94+ - 3 %

### ***Faqja e trete- kopja para CF coated front***

<i>Pesha:</i>	60 + - 4% g/m <sup>2</sup>
<i>Trashesia:</i>	73+ - 6 μm
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	MD > 12 mN
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	CD > 4 mN
<i>Lemueshmeria</i>	> 30 Bekk S
<i>Lageshtira relative</i>	50+ - 8 %
<i>Ndriçimi</i>	94+ - 3 %

*Për sa më sipër, pretendimi juaj vlerësohet i drejtë.*



### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” ShPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nëpërmjet shkresës nr.1637/12 prot., datë 02.08.2022, protokolluar me tonën me nr.1556/4 prot., datë 04.08.2022, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë institucionit tonë aktin e trajtimit e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin e ankesës si më poshtë:

*Pika 2.3.2 Ishte:*

*2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhen Prill 2022 – Qershor 2022, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë mesatarisht 20 punonjës të siguruar në muaj.*

***Pika 2.3.2 Bëhet:***

***2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhen Prill 2022 – Qershor 2022, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë mesatarisht 15 punonjës të siguruar në muaj.***

*Pika 2.3.5 Ishte:*

*2.3.5 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 2 makina tip furgon në pronësi ose me kontratë qeraje me afat kohëzgjajtje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës, për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet duhet të jenë të pajisura me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikat pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/ SGS”.*

***Pika 2.3.5 Bëhet:***

**2.3.5 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 1 makinë tip fugon në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës; për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet duhet të jenë të pajisura me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjete dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/ SGS”.**

*Pika 2.3.4 Ishte:*

*2.3.4 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të provohet lidhja mes prodhuesit dhe distributorit të autorizuar, në rast se OE nuk është prodhues i këtyre artikujve, si dhe duhet të dorëzojë skedat teknike për letrat e përdorura gjatë prodhimit të letrës traktor. Specifikimet teknike të jenë të certifikuar dhe testuar nga prodhuesi (me firmë dhe vulë) ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje)”, Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet Letër A5, “Traktor” (3 kopje)”, Letër A4 “Traktor” në përputhje me specifikimet teknike përkatëse”.*

**Pika 2.3.4 Bëhet:**

**2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar për letrat e përdorura për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të dorëzojë skedat teknike për letrat e përdorura gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar dhe testuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje)”; Letër A4 “Traktor” ” (3 kopje)”. Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.**

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *I. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve*

ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vëre menjëherë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijëni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi. Akoma më tej KPP konstaton, se operatori ekonomik ankimues pas kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor në lidhje me pretendimet e tij, nuk ka paraqitur argumente në lidhje me kthim-përgjigjen e këtij të fundit. Në këto kushte, bazuar në pikën 3 gërma “a” të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” ShPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Njëpërmjet shkresës nr.1637/15 prot., datë 04.08.2022, protokolluar me tonën me nr.1589/2 prot., datë 08.08.2022, si dhe shkresës nr. 1637/22 prot datë 08.08.2022 protokolluar me tonën nr. 1589/3 prot datë 09.08.2022 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë institucionit tonë aktin e trajtimit e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.2.3. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pjesërisht pranimin e ankesës si më poshtë: [...]Lidhur me pretendimin e nritur për kriterin e vendosur parashikohet:

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Certifikate ISO 9001:2015; ( për sistemin e menaxhimit të cilësisë); (ose ekuivalente)*
- *Certifikate ISO 14001:2015, (për sistemin e menaxhimit mjedisor); (ose ekuivalente)*
- *Certifikate ISO 45001:2018 (për sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë për kompaninë) (ose ekuivalente)*

(Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

*Ku kërkohet sqarim nëse ISO-t kërkohet të jenë të treja të operatorit ofertues?*

*Ju sqarohet se:*

Në dst për përmbushjen e këtij kriteri kërkohet që të tre ISO-të të jenë të operatorit ofertues (kompanisë ofertuese) pasi edhe nga rekomandimet e APP-së këshillohet të mos kërkohet Certifikatë ISO për kompani të treta. Edhe nëse shqyrtoni procesverbalin e argumentimit të kriterëve publikuar së bashku me dokumentet e tenderit në SPE ndër të tjera për argumentimin e pikës 2.3.2 është argumentuar se:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Megjithatë me qëllim shmangien e çdo konfuzioni për operatorët ekonomikë të interesuar lidhur me këtë procedurë prokurimi do të behën sqarimet dhe modifikimet përkatëse.

Pika 2.3.3.

### **Ishte**

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikate ISO 9001:2015; ( për sistemin e menaxhimit të cilësisë); (ose ekuivalente)
- Certifikate ISO 14001:2015, (për sistemin e menaxhimit mjedisor); (ose ekuivalente)
- Certifikate ISO 45001:2018 (për sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë për kompaninë) (ose ekuivalente)

(Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Pika 2.3.3.

### **Bëhet:**

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Certifikate ISO 9001:2015; ( për sistemin e menaxhimit të cilësisë për ofertuesin); (ose ekuivalente)

Certifikate ISO 14001:2015, (për sistemin e menaxhimit mjedisor për oferuesin); (ose ekuivalente)

Certifikate ISO 45001:2018 (për sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë për kompaninë për ofertuesin) (ose ekuivalente)

(Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Për sa më sipër pretendimi juaj vlerësohet i drejtë.

Lidhur me pretendimin e ngritur për specifikimet teknike ku është kërkuar:

III. Letër A5 “Traktor” në 3 kopje

IV. Letër A4 “Traktor” në 3 kopje

Ju sqarojmë se:

Në shtojcën 5 specifikimet teknike për produktin Letër A5 Traktor (3kopje) letër A4 “Traktor” (3 kopje)do të bëhen modifikimet teknike si vijon:

### **Ishte:**

### **III. Letër A5 "Traktor" në 3 kopje**

- -format A5, letër vetekopjuese.
- -letër traktor me 3(tre) kopje, të treja të bardha.
- -me biosjje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforcuar.
- -paketimi në kuti me 1400 fije treshe.

### **IV. Leter A4 "Traktor" ne 3 kopje**

- -format A4, letër vetekopjuese.
- -letër traktor me 3(tre) kopje, të treja të bardha.
- -me biosjje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforcuar.
- -paketimi në kuti me 1400 fije treshe.

## **Bëhen**

### **3. Letër A5 "Traktor" në 3 kopje**

- -format A5, **me përmasat e jashtme 234±5mm x 304/152±5mm**, letër vetekopjuese,
- -letër traktor me 3(tre) kopje, të treja të bardha.
- -me biosjje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforcuar.
- -paketimi në kuti me 1400 fije treshe.

#### **Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back**

Pesha :	58 + - 4% g/m <sup>2</sup>
Trashësia:	80+ - 6 µm
Ashpersia ne perkulje:	MD > 11 mN
Ashpersia ne perkulje:	CD > 3 mN
Lemueshmeria	> 15 Bekk S
Lageshtira relative	50+ - 8 %
Patejdukshmeria	> 79 %
Ndricimi	102 + - 3 %

#### **Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back**

Pesha:	58 + - 4% g/m <sup>2</sup>
Trashësia	78+ - 5 µm
Ashpersia ne perkulje:	MD > 11 mN
Ashpersia ne perkulje:	CD > 3 mN
Lemueshmeria	> 30 Bekk S
Lageshtira relative	50+ - 8 %
Ndriçimi	94+ - 3 %

#### **Faqja trete- kopja para CF coated front**

Pesha:	60 + - 4% g/m <sup>2</sup>
--------	----------------------------

Trashesia:	73+ - 6 $\mu$ m
Ashpersia ne perkulje:	MD > 12 mN
Ashpersia ne perkulje:	CD > 4 mN
Lemueshmeria	> 30 Bekk S
Lageshtira relative	50+ - 8 %
Ndriçimi	94+ - 3 %

#### 4. Leter A4 "Traktor" ne 3 kopje

- -format A4 me përmasat e jashtme: 234±5mm x 304± 5mm, letër vetekopjuese,
- -letër traktor me 3(tre) kopje, të treja të bardha.
- -me biosjje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e përformuar.
- -paketimi në kuti me 1400 fije treshe.

##### **Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back**

Pesha:	58 + - 4% g/m <sup>2</sup>
Trashesia:	80+ - 6 $\mu$ m
Ashpersia ne perkulje:	MD > 11 mN
Ashpersia ne perkulje:	CD > 3 mN
Lemueshmeria	> 15 Bekk S
Lageshtira relative	50+ - 8 %
Patejdukshmeria	> 79 %
Ndriçimi	102 + - 3 %

##### **Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back**

Pesha:	58 + - 4% g/m <sup>2</sup>
Trashesia:	78+ - 5 $\mu$ m
Ashpersia ne perkulje:	MD > 11 mN
Ashpersia ne perkulje:	CD > 3 mN
Lemueshmeria	> 30 Bekk S
Lageshtira relative	50+ - 8 %
Ndriçimi	94+ - 3 %

##### **Faqja trete- kopja para CF coated front**

Pesha:	60 + - 4% g/m <sup>2</sup>
Trashesia:	73+ - 6 $\mu$ m
Ashpersia ne perkulje:	MD > 12 mN
Ashpersia ne perkulje:	CD > 4 mN
Lemueshmeria	> 30 Bekk S
Lageshtira relative	50+ - 8 %
Ndriçimi	94+ - 3 %

Për sa më sipër, pretendimi jauj vlerësohet i drejtë.

III.2.4. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.2.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” ShPK, se: “Në pikën 2.10 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshje kuadër, AK është shprehur:

*Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është 62,891,062 (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e dy) Lekë, pa TVSH.*



*Pra AK është shprehur për shumatore, nëse ka disa artikuj. Duke marrë parasysh se kjo procedurë prokurimi ka më shumë se 1 artikull, shumatorja na kufizon aq më tepër që është më e lartë se fondi limit i përcaktuar. Kërkojmë shpjegimin dhe saktësimin e kësaj pike.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit “Infosoft Office” SHPK lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se: “[...] Lidhur me pretendimin e ngritur në ankesë ku i referohemi pikës 2.10 të DST-ve ku kërkohet shpjegime për saktësim lidhur me vlerën e plotë të fondit limit, ju sqarojmë se:

*Dokumentat standarte të tenderit janë hartuar në përputhje me setin e dokumentave të përgatituara dhe të miratuara nga APP-ja Dokumenta Standarte të TenderitnProcedurë e hapur mallra.*

*Referuar faktit që procedura është me lote gjatë hedhjes së të dhënave të procedurës në SPE vetë sistemi i prokurimit publik të detyron që në fillim të hedhësh vlerën e plotë të gjithë procedurës dhe më pas të vazhdohet me lotet.*

*Në dst dhe në njoftimin e kontratës është mjaft e qartë vlera totale limit e prokurimit si dhe vlera limit e secilit lot të kësaj procedure e konkretisht*

*Fondi limit: 62,891,062 (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e dy) Lekë, pa TVSH*

*Loti i I-rë: “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”, me vlerë 28,918,530 (njëzet e tetë milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) Lekë, pa TVSH.*

*Loti i II-të “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, me vlerë 33,972,532 (tridhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) Lekë, pa TVSH.*

*Për sa më sipër pretendimi juaj vlerësohet jo i drejtë.[...]”*

III.3.2. Në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt-ankimi në pikën 2.10 përshkrimi i shkurtër i kontratës përcaktohet si më poshtë:

#### *2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/ Marrëveshjes Kuadër*

*1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: Monedha, pa TVSH.*

*2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është 62,891,062 (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e dy) Lekë, pa TVSH \_*

*Loti i I-rë: “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”, me vlerë 28,918,530 (njëzet e tetë milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) Lekë, pa TVSH.*

*Loti i II-të “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, me vlerë 33,972,532 (tridhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) Lekë, pa TVSH*

III.3.3. Në dokumentet standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik përcaktohet si më poshtë:

## 2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës \_\_\_\_\_
2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është** \_\_\_\_\_
3. Burimi i Financimit \_\_\_\_\_
4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër \_\_\_\_\_

III.3.4. Neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se :

*Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

*3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.*

III.3.5. Referuar sa më lart, nga krahasimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi dhe setit standard të dokumenteve të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik konstatohet, se autoriteti kontraktor nuk ka plotësuar në përputhje të plotë me setin standard të dokumenteve të tenderit pikën 2.10 përshkrimi i shkurtër i kontratës të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Konkretisht autoriteti kontraktor në dokumentet e

procedurës së prokurimit objekt-ankimi ka përcaktuar, në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është 62,891,062, kur në fakt vlera 62,891,062 është vlera totale e fondit limit për të dyja lotet dhe jo shumatorja e çmimeve për njësi. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin dhe saktësimin e kësaj pikë duke përcaktuar vlerën e fondit limit në pikën 1 të seksionit 2.10 dhe në pikën 2 të vendosë vlerën e saktë të shumatores së çmimeve për njësi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-35897-07-08-2022, me objekt Loti II “Blerje Letër A5 “Traktor” (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, me fond limit 33.972.532 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 15.08.2022, nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA.
2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në përputhje me konstatimet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK.

7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK.
  8. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
  9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**